



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 09, datë 20.01.2020

**PËR MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË, FIGURËS  
DHE INTEGRITETIT SI DHE KUSHTEVE TË TJERA LIGJORE TË KANDIDATIT  
TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS Z. ADNAN HOXHA**

Mbështetur në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 184, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", si dhe pasi u njoh me Relacionin për miratimin e relacionit mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore dt. 20.01.2020, të kandidatit për t'u emëruar magjistrat Prokuror, z. Adnan Hoxha;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit dt. 20.01.2020, të kandidatit për Prokuror, z. Adnan Hoxha, sipas tekstit bashkëlidhur, duke lejuar kandidimin e tij.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI


ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ



ANËTAR  
VATË STAKA



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

*Kundër me opinion*



ANËTAR  
BESNIK CANI